



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:176259

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06736135

P.nr.107/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci me pjesëmarrjen e Bashkëpuntores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit, Sh B nga fsh.D K.K, i akuzuar për shkak të veprës penale;Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve nga neni 346 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//IL.nr.1770/2023 e dt.19.06.2024 në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.16.12.2024, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurit të lartë cekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt.17.12.2024, në të njëjtën ditë shpalli aktgjykimin ndërsa me datën:21.01.2025 e përpiloi këtë.

### A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurin: Sh B i lindur me dt. në fshatin Gj i M K.K, tani me banim në fshatin D-K.K, nga babai Z B dhe nënës N B e gjinis M, ka të kryer shkollën fillore, me profesion puntorë fizik, i martuar, baba i fëmijve, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

### ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt.22.01.2 dhe me dt.05.07.2023 në fsh.D K.K, me dashje direkte dhe në dijeni për pasojat që mund të shkaktohen tek kafsha në organizimin, financimin dhe pjesëmarrjen si nikoqir në luftra, organizon luftën në mes të qeneve në atë mënyrë që i pandehuri e dërgon qenin e tij në luftë me qentë e tjerë të fshatit e në kohen gjersa qentë luftojnë mes vete i pandehuri i inxizon e më pas xhirimin e shpërndan në rrjete sociale.

-me çka ka kryer veprën penale, Keqëtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve nga neni 346 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 50,51,52, 69, 70 dhe 73 dhe nenit 346 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, :

## GJYKON

### DËNIM ME KUSHT

I. Me denim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, në qoftë se i pandehuri, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër tjetër penale.

II. LIROHET: I pandehuri nga shpenzimet e procedurës penale konform nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

III. Udhëzohet- pala e dëmtuar „Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve” të cilën e përfaqëson E R, që kërkesën pasurore juridike të realizojë në kontest të rregullt civil.

### A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale:

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë me PP//II.nr.1770/2023 e dt.19.06.2024, kundër të akuzuarit: Sh B nga fsh.D K.K, i akuzuar për shkak të veprës penale, Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve nga neni 346 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me dt.me dt:17.12.2024, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar lidhur me këtë qështje juridiko-penale, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Pejë, Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala i akuzuari Sh B.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari lidhur me fajsisinë për veprën penale për të cilën akuzohet, deklarohet se: e pranoj fajësin për veprën penale që i vihet në barrë, pendohem për veprën e kryer dhe premtim se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të vepra të ngjajshme penale, dhe se kur une kam shkuar e kam lëshuar qenin në mbrëmje, ndërsa ai në mëngjes u kaxafyt me qenë të tjerë, ku për këtë fakt une nuk e kam ditur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajsisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit, pasi ky pranim i fajsisë është bërë pa presion, me

vullnet nga i pandehuri, i propozoi Gjykatës që të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit ndërsa si rrethanë lehtësuese ta merr pranimin e fajsisë.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajsisë.

Gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajsinë nga i akuzuari Sh B për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 184 par.1 të KPPK-së. Në këtë aspekt Gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajsisë, ka vlerësuar se pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e qështjës që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktkike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari i lartëcekur, ka kryer veprën penale, Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve nga neni 346 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## 4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata ka vendosur që të akuzuarin e lartëcekur, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqense është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siq edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se siq e ka pranuar edhe vet, i akuzuari në ditën kritike për të cilën akuzohet ka ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit Sh B, Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, ka kërku falje publike palës së dëmtuar, të cilin e ka djalë. I njëjti për

herë të parë ka rënë ndesh me ligjin. Ashtu qe gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më veprën penale.

Ndërsa, Gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen direkte të kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën e kryerjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

7. Sipas bindjës së gjykatës, dënim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej **një (1) viti**, nga dita e plotëfuqishmësisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen tjetër vepër penale, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

I pandehuri u lirua nga shpenzimet për shkak se është shfrytëzues i skemes sociale, i cili i ka dorëzuar gjykatës dëshminë-kartelen sociale e lëshuar nga Qendra për ndihmë dhe Punë sociale në Klinikë me nr. të regjistrimit të ndihmës sociale 35173.

Gjykata ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë qe të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet

Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës penale u muarr në bazë të nenit 452 par.4 të KPRK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463, të KPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palën e dëmtuar që kompensimin e dëmit ta realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 248 dhe nenit 364 dhe 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.107/2024 me datë.21.01.2025

Bashkëpuntorja Profesionale  
Fatmire Elezaj

Gjyqtarja Gjykuese  
Sabrije Rraci

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ( tridhjetë ) ditëve nga Dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.